



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 332 Prot

Fier më, 11 .09.2025

Lënda: Njoftim për Levizje paralele .

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit Nr 759 datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë menaxhimit te burimeve ,përberës së njesisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit të vazhdueshem professional të personelit ” i ndryshuar .

Ofruesi i AFP_së, Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin me kohe te pjeseshme :

-instruktor i praktikës profesionale ne kursin Punime Duralumini IEVP (Fier)1 person

2. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- Të demostroj aftësi te punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a)Të ketë te paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale , pas te mesme ose parauniversitare në të njejtnë fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale per te cilin po aplikon .
- b)Të kete të paktën 3(vjet) përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet :

c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit .

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë/deftese e shkollës së mesme
- libreza e punës
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim CV;
- çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjëndjes shëndetësore
- vërtetimin e gjëndjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara te tyre ; Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës 24.12.2025

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.5.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTOR
Odeta KUELA

